

VENDIM
Nr.956, datë 24.11.2010

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHKODRËS TË PRONËS NR.373 “ISH-GRUP ARTILERIE”, NË TEPE, SHKODËR, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të pronës nr.373 “Ish-grup artilerie”, në Tepe, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për ta përdorur për realizimin e programeve mësimore, ndërtim shkolle, objekte sociale, kulturore, sportive dhe të shëndetit publik, në qytetin e Shkodrës.

2. Prona nr.373, me emërtesë “Ish-grup artilerie”, në Tepe, Shkodër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Shkodrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Dorëzimi i kësaj prone të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të cilat janë depozituar në këtë pronë.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Shkodrës, si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha